⁴Kjo deklarate ka si qellim plotesimin e kriterit ligjor qe operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

Shtojca 12

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*

f. *Deklaratën bi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- **Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (Shtojca 12)**

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve për vitet (2017, 2018, 2019), të paraqitur pranë autoritetit përkatës Dega e Tatim Taksave, të konfirmuar nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur shoqëria ofertuese është subjekt që në përputhje me aktet ligjore në fuqi duhet të kryejë akt ekspertizën e ekspertit kontabel të autorizuar.

2. Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se 50% e vlerës së fondit limit perkatesisht: **228,262,768** (dyqind e njëzet e tetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH.**

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin (2020) sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar . Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e informacionit te paraqitur.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë: Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 35 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **159,783,937** (njëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**, të realizuar gjatë tri viteve të fundit, datë e përlogaritur nga data e hapjes se ofertave.
- b) Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, datë e përlogaritur nga data e hapjes se ofertave, është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet .

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e bën oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontratë Sipërrmarje
 3. Situacionin përfundimtar;
 4. Aktin e kolaudimit;
 5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikaten e përkohëshme të marrjes ne dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontratë Sipërrmarje ;
 3. Situacionin përfundimtar;
 4. Akt kolaudimi objekti;
 5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
 6. Fatura tatimore për situacion përfundimtar.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.4 Licensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

Operatorët ekonomike duhet të deshmojnë se disponojnë license profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës.

Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008; *Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar.

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP 1 – D (punime gjurmimi në tokë)
- NP - 2 - C; (Ndërtime civile dhe industriale)
- NP 4 - E; (Rrugë autostrada, ura, mbikalime....)
- NP 5 -A; (Punime nëntoksore, ura vepra arti)
- NP 7a-A; (Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)
- NP 12 - A; (Punime të inxhinierisë së mjedisit)
- NS - 2 A; (Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre)
- NS 4 – A; (Punime rifiniture.....)
- NS 9-D; (Punime strukturore speciale)
- NS - 14 A;(Impiante të brendshme elektrike, telefonike, etj)
- NS 16 E; (Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij)
- NS 18 D; (Punime topogjeodezie)

- NS - 19 D;(sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastyukturë)
- N.S 20 D; (Shpime gjeologo –inxhinierike, puse shpimi për ujë

sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njëhsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë përkatëse, sic përcaktohet në *Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr.42, datë 16.01.2008.*

2.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e kontratës. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar operatorit ekonomik duhet të paraqesë liçencat:

- III.2.B;I.2.A;III.2.A (1+2);III.1.A;

2.6 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm

- i. Diplomë
- ii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

Në rastin e Bashkimit të operatorëve Ekonomik secili operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin teknik të punimeve në objekt I cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës të preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

2.7 Një punësim mesatar i të paktën 300 (treqind) personave, për periudhën Janar 2020- Dhjetor 2020 të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2020- Dhjetor 2020, të vërtetuar me;
- Listë pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për secilin muaj të periudhës së mësipërme.

2.8 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik të përfshirë në liçencën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 2 (dy)
- Inxhinier Ndertimi 1 (nje) (profili transport)
- Inxhinier Ndertimi 1 (nje) (profili strukturist)
- Inxhinier Hidroteknik 3 (tre)
- Inxhinier Gjeodet 2 (dy)
- Inxhinier Gjeolog 2(dy)
- Inxhinier Mekanik 2 (dy)
- Inxhinier Elektrik 2 (dy)
- Inxhinier Mjedisi 1 (nje)
- Inxhinier elektronik 1 (nje)
- Inxhinier gjeoteknik 1 (nje)

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

2.9 Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij te punesuar (staf mbështetës)39erti poshtë:

- 1 inxhinier topograf;
- 1 inxhinier ndërtimi;
- 1 agronom/ inxhinier ekuivalent;
- 1 inxhinier mjedisi profil "Trajtim i ujrave";

Operatori ekonomik te paraqesë per stafin e mesiperm kontratat e punes, diplomen perkatese per secilin punonjes. Stafi i mësipërm te figuroje ne listepagesat e shoqërisë per 3 (tre) muajt e fundit.

2.10.Operatori ekonomik duhet të disponojë pjesë të stafit të tij punonjës të pajisur me deshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi, kontratat e punes te vlefshmeku nga këta të jenë të paktën:

- Specialist ndërtimi –2punonjës;
- Hidraulike -8 punonjës;
- Montues tubosh – 5 punonjes;
- Elektracistë -5 punonjës;
- Saldatorë -3 punonjës;
- Hekurkthyes -2 punonjës;
- Karpentier – 2 punonjës;
- Pllakashtrues – 2 punonjes;
- Murator – 3 punonjes;
- Hidroizolues – 2 punonjes;
- Bojaxhi – 2 punonjes;
- Suvatues – 2 punonjes;
- 1 teknik gjeometer;
- 2 teknik mekanike
- 5 teknik ndertimi
- Automakinist- 7 punonjës;
- Eskavatorist me goma dhe/ose zinxhir – 8 punonjes

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

Për punonjësit Automakinist dhe Eskavatorist me goma dhe/ose zinxhir duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit .

2.11.1(nje) punonjës që përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise per për të paktën 3(tre) muajt e fundit. *Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.*

2.12. Operatori ekonomik duhet të disponojë pjesë të stafit :

a. ekspert zjarrfikës të certifikuar (1 person) në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, dëshmuar me kontratën e punës dhe certifikatën përkatëse .

(Për ekspertin zjarrfikës operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e ekspertit zjarrfikës si dhe Kontratën e punës (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të ndërtimit). Punonjësit e sipërcituar duhet të figurojnë në list pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

2.13 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e cilesisë së punimeve **ISO 9001- 2015** (e vlefshme). *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*
- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën **ISO 14001-2015** (e vlefshme). *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*
- Shoqëria duhet të paraqesë Certificate **OHSAS 18001-2007**(e vlefshme)/ose SSH 45001-2018 *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*
- Shoqëria duhet të paraqesë Certificate **PAS 99-2012**(e vlefshme)*(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

2.14.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamiona vetshkarkues min 16 ton kap. Mbajtes	në pronësi ose me qira	Cope 10
2	Kamioncina vetshkarkues nga 3 deri ne 5 ton kap. Mbajtes	në pronësi ose me qira	Cope 4
3	Kamioncina deri 3.5 ton kap. Mbajtes	në pronësi ose me qira	Cope 1
4	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Cope 4
5	Autovinc	në pronësi ose me qira	Cope 1
6	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Cope 2
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 2
8	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 5
9	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 3
10	Motobetoniere	në pronësi ose me qira	Cope 6
11	Pompa uji	në pronësi ose me qira	Cope 2
12	Fadroma me goma (skrep)	në pronësi ose me qira	Copë 4
13	Bobcat	në pronësi ose me qira	Cope 2
14	Ekskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 4
15	Ekskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 8
16	Eskavator te rende per thyerje guri	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Cekic pneumatik per thyerjen e betoneve	në pronësi ose me qira	Cope 3
18	Mini ekskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
19	Motogjenerator/gjenerator	në pronësi ose me qira	Cope 2
20	Saldatrice/motosaldatrice	në pronësi ose me qira	Cope 2
21	Sonde per shpime horizontale per kalim tubash nen trasene e rruges	në pronësi ose me qira	Cope 1
22	Sonde per shpime vertikale per kalim tubash nen trasene e rruges	në pronësi ose me qira	Cope 1
23	Aparatura per bashkim tubacionesh me metoden "Elektro Fusion Joint"	në pronësi ose me qira	Cope 8
24	Aparature elektronike per kontrollin e presionit, pompe presioni deri 40 bar per te realizuar proceduren e testeve te presionit sipas EN 805 ose ekuivalente	në pronësi ose me qira	Cope 1
25	Kompresor ajri	Në pronësiose me qira	Copë 1
26	Tokmak	Në pronësiose me qira	Copë 1
27	Grejder	Në pronësiose me qira	Copë 2
28	Rul	Në pronësiose me qira	Copë 3
29	Asfaltoshtrues	Në pronësiose me qira	Copë 4
30	GPS	Në pronësiose me qira	Copë 1
31	Matrapik	Në pronësiose me qira	Copë 1
33	Nyje thyerje materiale inerte e pajisur me leje	Në pronësiose me qira	Copë 1

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

	mjedisore		
34	Fabrike Asfalti pajisur me leje mjedisore	Në pronësi ose me qira	Copë 1
35	Fabrike Betoni pajisur me leje mjedisore	Në pronësi ose me qira	Copë 1
36	Pompe stacionere per hedhje betoni (shoqeruar me foto)	Në pronësi ose me qira	Copë 1
37	Sistem Eëllpoint/ekuivalent per heqje ujrash (shoqeruar me foto)	Në pronësi ose me qira	Copë 1
38	Autofshese	Në pronësi ose me qira	Copë 1
39	Pajisje per boje bikomponente	Në pronësi ose me qira	Copë 1
40	Freze asfalti	Në pronësi ose me qira	Copë 2
41	Sharre asfalti	Në pronësi ose me qira	Copë 2
42	Pajisje hidrombjellje	Në pronësi ose me qira	Copë 1
43	Fabrike bitumi	Në pronësi ose me qira	Copë 1

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- c) Kokore minimumi 300 copë
- d) Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 20 copë
- e) Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 10 copë
- f) Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 6 copë
- g) Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 20 copë
- h) Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 30 copë

-Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme),f) taksat vjetore; g) certifikatë për transport mallrash të rrezikshme (per mjetet që trasnportojne mallra të rrezikshëm).

-Për mjetet e deklaruar me qera, krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases e cila dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.

-Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

- Për fabrikën e betonit, asfaltit, bitumit dhe nyjen e inerteve ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine e saj, Leja mjedisore leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit planimetri dhe dokumentacion qe verteton pronesine.
- Ne rast se fabrikën e betonit, asfaltit, bitumit dhe nyjen e inerteve eshte me qera duhet te paraqitet kontrata e qerases e shoqeruar me dokumente qe vertetojne pronesine e saj, Lejen mjedisore leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit. Planimetri dhe dokumentacion qe verteton pronesine.

-Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerases, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

-Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjete dhe targa e tij.

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në shtojcën 10 në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara sipas shtojcës 10 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga Autoritetet Kontraktore.

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

2.15.Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Kontrate furnizimi me furnizuesin e tubave HDPE dhe PVC plastike sipas preventivit qe do te vendosen ne objekt, shoqëruar me katalogjet teknike të mallrave (HDPE dhe PVC, plastike).Në rast se katalogjet janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer dhe noterizuara sipas legjislacionit në fuqi.

2.16.Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Kontrate furnizimi për pllaka që do të vendosen në objekt sipas preventivit të kontratës objekt prokurimi.

2.17.Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- i) Hekur;
- j) Pajisje Hidroizoluese;

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

k) Pompa;

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet te shoqerohet edhe me dokumentacionin qe verteton lidhjet e firmes prodhuese me distributorin (kontratë/autorizim).

2.18. Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

a) Matesa uji;

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet te shoqerohet edhe me dokumentacionin qe verteton lidhjet e firmes prodhuese me distributorin (kontratë/autorizim).

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë katalogjet për mallrat matësa uji.

Në rast se katalogjet janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer dhe noterizuara sipas legjislacionit në fuqi.

Rastet e detyrimeve te meparshme kundrejt Bashkise si : gjoba, debi te ndryshme, moszbatim ne kohe dhe sipas kushteve perkatese te kontratave te meparshme, te dokumentuara me njoftime, procesverbale etj, (shoqëruar me vërtetim) do te perbejne kusht per s'kualifikim te operatorit/operatoreve ekonomik perkates.

Ne rastet e pjesemarrjes se operatoreve ekonomik te huaj, detyrimisht te gjitha dokumentat te jene te apostiluar sipas legjislacionit ne fuqi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Në preventivin e punimeve objekt prokurimi në respektim të nenit 23 të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj.”

Në specifikimet teknike objekt prokurimi në të gjitha rastet kur përmenden standartet EN pranohet termi sipas standartit SSH.

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike tëpunëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

Shtojca15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

<Emri>

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit,brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimittë këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo_____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

Shtojca 18

**KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS
Punët – Procedura e Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotësuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afatii realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

"Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec".

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

